



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse



Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2022

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor shpall vend të lirë pune për:

- **1 (një) Specialist Fusha e Ekonomisë në Sektorin e Financë-Administratës pranë Drejtorisë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Shkodër.**

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
- Të jetë në kushte shëndetësore të mira për të kryer detyrat përkatëse;
- Të mos jetë dënuar për vepra penale dhe të mos ketë proces në prokurori apo gjykatë;
- Të mos jetë pushuar më parë nga administrata e FSDKSH-së apo Shërbimi Civil për thyrje të disiplinës a shkelje të tjera serioze;
- Të ketë mbaruar Arsimin e lartë Ekonomi.
- Të jetë i komunikueshëm dhe të ketë aftësi të punës në grup;
- Njohuri bazë në kompjuter;
- Zotërimi i gjuhëve të huaja do të jetë avantazh (preferohet anglisht);
- Nota mesatare do të jetë avantazh.

Të interesuarit duhet të paraqesin dokumentat pranë Drejtorisë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Shkodër, **brenda datës 24.02.2022**, këto dokumenta;

- Kërkesë me shkrim për t'u punësuar;
- Jetëshkrimi i plotësuar (CV);
- Diplomë e noterizuar (për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit);
- Diplomë Master e noterizuar;
- Listë notash e noterizuar;
- Dëshmi për kualifikime të ndryshme;
- Referencë pune nga vendi ose vendet e punës ku ka punuar;
- Fotokopje e Librezës së Punës që vërtetojnë eksperiencën në punë;
- Fotokopje e kartës së identitetit (ID);
- Dëshmi penaliteti (të datojë brenda 3 muajve të fundit);

- Raport mjekësor për aftësi në punë.

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose fotokopje të noterizuara. Dokumentat të dorëzohen në zarf të mbyllur, i cili protokollohet.

Adresa: Drejtoria Rajonale e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Shkodër , L.: Perash, Rr: “Daut Boriçi”, pranë sheshit ”Isa Boletini”, Shkodër ; 4001; Shqipëri.